



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
ADMINISTRATORI



Nr. 185 Prot.

Tiranë më, 18.02.2019

Lënda: Njoftim administrativ

Drejtuar: -Degës së Financës
-Degës së IT
KËTU

Për dijeni: Dekanit të FHF-UT
Prof.Dr.Sabri LAÇI

Për të realizuar me efektivitet procesin e arkëtimit të të ardhurave nga tarifat e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, të kihen parasysh sqarimet dhe të merren masat e mëposhtme:

- Bazuar në: **VKM nr.778, datë 26.12.2018** "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr.288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të traifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, *Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor)* do të paguajnë 50% të tarifës, **pra 15,000 lekë.**

- Studentët e Ciklit të Parë (Bachelor) të cilët i përkasin *kategorive përjashtimore dhe janë me mesatare 9-10*, sipas **VKM nr. 779, datë 26.12.2018** "Për disa ndryshime në Vendimin nr.269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që

përgjashtohen nga tarifat e shkollimit”, të ndryshuar, **nuk do të kryejnë asnjë pagesë për tarifën e shkollimit të vitit akademik 2018-2019.**

- *Studentët e Ciklit të Dytë të studimeve (Master Profesional dhe Master Shkencor)* që i përkasin kategorive sociale në nevojë dhe janë me mesatare 9-10, të cilët përfitojnë **50 % ulje** të tarifës së shkollimit do të paguajnë **30,000 lekë** për studentët e Masterit Profesional dhe **37,500 lekë** për studentët e Masterit Shkencor, sipas **VKM nr. 780, datë 26.12.2018** “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”.

-*Studentët e Ciklit të dytë të studimeve (Master Profesional dhe Master Shkencor)* të cilët **nuk bëjnë pjesë në kategoritë e studentëve që përfitojnë ulje të tarifës**, sipas VKM nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, do të paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik 2018-2019: **60,000 lekë** për studentët e Masterit Profesional dhe **75,000 lekë** për studentët e Masterit Shkencor.

- **Dega e Financës dhe Dega e IT** kanë për detyrë të nxjerrin njoftimet dhe sqarimet e mësipërme, si dhe faturat për tarifat e shkollimit të gjitha sistemeve dhe degëve të Fakultetit Histori-Filologji. Faturat e tarifave të jenë edhe on-line, me qëllim që të lehtësohen studentët për ti prokuruar dhe printuar. Njoftimet të nxirren në faqen zyrtare të FHF: www.fhf.edu.al, Facebook-un zyrtar të Fakultetit dhe monitorin e Informacionit.

- Të gjithë studentët duhet të pajisen paraprakisht me *faturën e arkëtimit*, sipas Urdhrit Nr. 95, datë 11.11.2009 të Ministrisë së Financave, e cila pasi nënshkruhet nga Institucioni një kopje i dorëzohet studentit nga **Punonjësja e Informacionit** për të kryer veprimet në Alpha Bank. Paraqitja e faturës tatimore është kusht i domosdoshëm për veprimet në bankat e nivelit të dytë. Pas pagesës studentët e dorëzojnë kopjen e mandatit tek Punonjësja e Informacionit, e cila kryen më tej veprimet e dorëzimit në Degën e Financës.

-Afati i kryerjes së këtij procesi do të jetë deri në përfundim të vitit akademik 2018-2019, sipas strukturës së përcaktuar nga MASR.

ADMINISTRATOR

Parashqevi POGACE

